



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – RÉPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK



GRUPI PUNUES PËR HARTIMIN E PROJEKT BUXHETIT TE KOMUNES SE JUNIKUT
PER VITIN 2024-2026

Dëgjimi i parë buxhetor
PROCESVERBAL

I mbajtur në dëgjimin e parë buxhetor me datën 15.06.2023 në sallën e Kuvendit Komunal, duke filluar në orën 11:00. Takimin e kryesoi Artën Hamza, Zyrtar Kryesor Financiar, Kryesues i grupit punues.

Takimin e I-rë buxhetor e hapi Artën Hamza si kryesues i Grupit Punues i formuar me vendim të kryetarit të komunës z. Ruzhdi Shehu.

Pasi përshëndeti dhe falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje, Artën Hamza filloi me prezantimin e dëgjimit të I-rë për Buxhetin, ai tha se Qarkorja e I-rë buxhetore 2024/01 është pranuar në Maj përkatësisht me 15.05.2023, më tutje theksoi se janë disa hapa dhe faza drejt hartimit të projekt buxhetit për periudhën 2024/2026 ku si dokument i parë kërkohet që të hartohet Korniza Afatmesme Buxhetore 2024/2026 e cila duhet që të hartohet dhe aprovohet deri me 30.06.2023 dhe të dërgohet në Ministrinë e financave, punës dhe Transfereve, pastaj do të lëshohet Qarkorja e dytë buxhetore e cila i përcakton kategoritë shpenzuese dhe në bazë të së cilës duhet që të hartohet projekt buxheti 2024/2026 dhe të aprovohet deri me 30 shtator.

Më tutje shpjegoi hapat e hartimit të KAB duke theksuar rëndësinë e mbajtjes së takimeve dhe dëgjimeve buxhetore deri te hartimi i KAB-it dhe projekt buxhetit.

Gjithashtu tha se edhe pse dihet se si komunë e vogël edhe mundësitë buxhetore janë të kufizuara, por prapë se prapë projekt propozimet merren parasysh dhe vendosen në strategji komunale.

Ai shtoi se Buxheti i përgjithshëm për 2024 sipas Qarkores se pare 2024/01 është 2,199,836.00 , nga këto si burim financimi janë:

- Granti i përgjithshëm 1,103,827.00
- Granti specifik për arsim 544,726.00
- Granti specifik për shëndetësi 343,227.00, dhe
- Të hyrat vetanake 208,056.00 .

Dhe nga kjo gjatë hartimit të buxhetit fillimisht planifikohen buxheti i shpenzimeve operative pastaj, pjesa tjetër planifikohet për investime kapitale ku përafërsisht planifikohet diku rreth 350,000.00 - 400,000.00 € për kategorinë e investime kapitale për vitin 2024.

Më tutje tha se ky grup punues i formuar sipas kërkesave ligjore për hartimin e buxhetit me vendim të kryetarit të komunës z. Ruzhdi Shehu, do të jetë përgjegjës për procedurat e planifikimit të buxhetit, dhe të gjitha propozimet do të pranohen dhe adresohen në drejtori përkatëse për t'u vendosur nëpër strategji. Pastaj projektet e propozuara nga pjesëmarrësit do të financohen dhe renditen sipas përparësisë (prioritetit) dhe rëndësisë.

KAB-i duke përfshirë edhe Listën e projekteve kapitale është i publikuar në web faqe të komunës dhe nga data 15.06.2023 - 26.06.2023 do të jetë i hapur konsultimi publik për dërgim/pranim të propozimeve, d.m.th grumbullimi i propozimeve deri me datë 26.06.2023.

Me kaq e mbylli prezantimin e tij kryesuesi i Grupit Punues z, Arten Hamza i cili më pastaj fjalën ua dha pjesëmarrësve për pyetje dhe propozime.

Nga të pranishmit fjalën e mori z. Xhavit Velijaj i cili tha se kërkesë e banorëve të lagjes është:

- Ndërtimi i sistemit të ujitjes së tokave në lokacionin Goqaj - Trojet

I cili konsiderohet si investim për ujitje të tokave bujqësore dhe propozohet të jetë sistem i mbyllur.

Pastaj fjalën e mori Artan Krasniqi i cili pasi përshëndeti të pranishmit dhe përgëzoi Grupin Punues për punën tha propozimin e tij:

- Ndërtimi i shtëpisë së pleqve në Junik.

Pastaj Tafë Gaxherri propozoi:

- Ndërtimi i kanaleve të ujitjes për tokat në lokacionin Bramatok,
- Riparimi i digës në Bramatok,
- Rregullimi dhe mirëmbajtja e hapësirave publike në qendër të lagjes Gaxherr i epërm,
- Rregullimi dhe mirëmbajtja e hapësirave publike në lokacionin Kukaj (krijimi i shesheve për shfrytëzim nga banorët).

Më pas z. Zenun Shala propozoi të ndahet fond për sanimin e 5 urave të rrugës së bjeshkës kah Gryka e Deçanit.

Dhe të ngritët si shqetësim çështja e de minimis në lokacionin "Butsinat" pasi që ka zëra që ai lokacion nuk është pastruar nga minat.

Pas këtyre propozimeve nuk pati ndonjë pjesëmarrës tjetër i cili dëshironte që të merrte fjalën dhe pastaj mori fjalën Arten Hamza dhe tha se Grupi Punues do ndjek procedurat, hartojë procesverbalin dhe raportin do i prezantohet ekzekutivit dhe kuvendit.

Gjithashtu shprehu shqetësimet e tij sepse pjesëmarrja në dëgjim buxhetor është e vogël dhe iu drejtua me kërkesë pjesëmarrësve që të ngritin si çështje dhe sa më shumë të sensibilizojnë qytetarët për pjesëmarrje. Gjithashtu tha se do të mbahen edhe takime tjera të grupeve të interesit.

Përveç projekteve dhe diskutimeve të mësipërme, kemi edhe projekt propozimet nga listat e shpërndara tek pjesëmarrësit e ato janë:

- Rikonstruimi i rrugës “Shkelzen Gacaferi”
- Hapja e rrugës malore “Livadhi i verrave – Fierza”
- Ndërtimi i Pikës grumbulluese për fruta të pyjeve (gështenja, boronica, etj)
- Rikonstruimi i rrugës në lokacionin Zalli i Rupes – Pllaqica e Junikut
- Rikonstruimi i rrugës së bjeshkës Gropa e Erenikut – Bjeshka e Gacaferit

Pastaj z. Arten Hamza mori fjalën përmbyllëse pasi nuk pati propozime tjera duke falënderuar znj. Have Lajçi nga OSBE, për pjesëmarrje dhe sensibilizimin e gruas që të jenë më aktive.

Për fund tha: inkurajoheni të merrni pjesë në dëgjime publike me qëllim të propozimit dhe realizimit të projekteve të cilat ndikojnë në përmirësimin e kualitetit të jetës së qytetarëve.

Faleminderit për pjesëmarrje dhe mirë u takofshim në dëgjimet e radhës.

Në këtë dëgjim publik ishin gjithsejtë 17 pjesëmarrës ku 6 nga totali i pjesëmarrësve ishin të gjinisë femërore.





REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK



Drejtoria për Buxhet dhe Financa

Datë: 15.06.2023

DËGJIMI I PARË PUBLIK PËR BUXHETIN 2024-2026

Numri	Emri dhe Mbiemri	Komuna	Nr. i telefonit	Email-i	Nënshkrimi
1	ARTEN HAMBA	JUNIK	044264079	arten.hamba@rks-gov.net	
2	FERDANE TOFAJ	JUNIK	044 788580	ferdane.tofaj@rks-gov.net	
3	VALBONA GAXHERRI	JUNIK	045 276 826	valbonagaxherri@hotmail.com	
4	SUNDIN KRASNIC	JUNIK	044-555-292	Sundin.Krasnici@rks-gov.net	
5	DEMË UKAJ	JUNIK	044 179 313	deme.ukaj@rks-gov.net	
6	Artyl Maloku	JUNIK	044 715 555	artyl.maloku@rks-gov.net	
7	Tafë Tafaj	JUNIK	044-178-730	Tafë.Tafaj@rks-gov.net	
8	Xhamit Veliqaj	JUNIK	044-270917	xhamit.veliqaj@qendreshtet.com	
9	Leonora Sheliu	JUNIK	046-406-300	leonorasheliu@hotmail.com	
10	Saranda Isufaj	JUNIK	045-379-004	saranda.isufaj@rks-gov.net	
11	Arton Krasnic	JUNIK	044-270923	arton.k.krasnic@rks-gov.net	

12	FLORINDA KUKALAJ	JUNIK	045/312-963	florinda.maloku@rks-gov.net	15.06.2023
13	JADRI KRASHI	JUNIK	045 691360	1-11 -	
14	ZENUN Shala	Junik	044 161809	zenunshala@yahoo.com	Zenun Shala
15	Jafë Gaxherri	Junik	048 445333	jafeg@live.com	Jafë Gaxherri
16	Demokrat Ganijaj	Junik	049 409-100	demokrat.ganijaj@rks-gov.net	Demokrat Ganijaj
17	Vjollca Qestaj	Junik	046-106286	vjollcaqestaj@rks-gov.net	Vjollca Qestaj
18					
19					
20					
21					
22					
23					
24					
25					
26					
27					
28					
29					
30					
31					
32					
33					
34					
35					
36					
37					